

VENDIM
Nr. 181, datë 8.3.2017

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË JOPUBLIK “KOLEGJI PROFESIONAL, PRIVAT, “NEW GENERATION””, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë jopublik “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, dhe mbylljen e të gjitha detyrimeve lidhur me veprimtarinë mësimore shkencore në ciklin e studimit ku ushtron veprimtarinë dhe për të gjitha programet e studimit të ofruara.

2. Institucioni i arsimit të lartë jopublik “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, të arkivojë të gjithë dokumentacionin mësimor, administrativ dhe financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, në përputhje me kuadrin ligjor mbi arkivat, brenda datës 31 mars 2017.

3. Vula e institucionit të arsimit të lartë jopublik “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e këtij institucioni jopublik të arsimit të lartë, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik privat që i përfaqëson. Institucioni i arsimit të lartë “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, duhet të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, në rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të ketë ndaj studentëve.

5. Për studentët që nuk kanë përfunduar programet përkatëse të studimit, institucioni i arsimit të lartë jopublik “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, të përgatisë, për çdo student, dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve, dhe ta vërë atë në dispozicion të studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda një kohe sa më të shpejtë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe institucioni i arsimit të lartë jopublik “Kolegji Profesional, privat, “*New Generation*””, Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama